

PROGRAMI I STUDIMIT:

Elektronike si dhe ne Automatike dhe Robotike (semestr i pestë)

Course code: EAR2021_B_S05E_06_01 & EAR2021_B_S05A_06_01

Course: **Entrepreneurship** (2+0+0) 3 ECTS

Lecturer: Nora Sadiku-Dushi

Course status: Elective

Përmbajtja e kursit: Promovimi i një kulture kreativiteti, inovacioni dhe bashkëpunimi. Promovimi i kulturës së sipërmarrjes si profesionale ashtu edhe studentore. Gjenerimi, shpërndarja dhe shkëmbimi i njohurive mbi inovacionin dhe ndërmarrësinë. Zhvillimi i aleancave strategjike me agjentë që strukturojnë ekosistemin e inovacionit dhe ndërmarrësisë. Njihja me mjetet dhe strategjitë që do të aplikohen për startup-et dhe projektet. Menaxhimi i kreativitetit dhe inovacionit. Dështimi dhe mësimi nga dështimi. Kuptimi dhe menaxhimi i proceseve të inovacionit dhe ndikimet e tyre në mjedis.

Objektivat e lëndës: Në këtë lëndë studentët do të mësojnë rreth kontekstit të zhvillimit të konsumatorit në jetën reale dhe do të fitojnë aftësi për të zhvilluar idenë e tyre të biznesit gjatë gjithë rrugës nga koncepti në fazën e tregut deri te ndërmarrja dhe inovacioni i tyre. Kjo lëndë artikulon një hapësirë inovative që synon të jetë pasardhëse e projekteve të inkubacionit ndërmarrës në Kosovë. Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të jenë në gjendje të realizojnë ëndrrat e tyre dhe të zhvillojnë aftësitë për t'i arritur ato në inovacion dhe ndërmarrësi. Lënda është krijuar për të inkurajuar aftësinë e studentëve për të menduar ndryshe rreth zhvillimit të produkteve, shërbimeve dhe organizatave të reja.

Rezultatet e mësimi:

- Punë ndërdisiplinore, mjedise reale dhe virtuale;
- Përvojë në të mësuarit rreth inovacionit;
- Të mësuarit së bashku me ndërmarrësit;
- Kreativiteti në menaxhimin e shkëlqyer të kohës dhe burimeve;
- Krijimi dhe përdorimi i një rrjeti të paçmuar talentesh ambicioze me të njëjtin mendim.

Metodologjia e mësimdhënies: 30 orë ligjërata dhe afërsisht 45 orë punë të pavarur duke përfshirë punë seminarike.

Metodat e vlerësimit: Ndjekja dhe përfshirja e rregullt në diskutime dhe raste studimi 10%, Intervdita me ndërmarrës 10%, Plani i biznesit 20%, kolokvium i parë 30% , kolokviumi i dytë 30%. Provimi përfundimtar: 60%.

Mjetet e konkretizimit/TI: Kompjuter, projektor, softuer të ndryshëm.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike: 40:60

ORARI

Java 1	Ligjerata	Njoftim me syllabusin
Java 2	Ligjerata	KONCEPTI I NDËRMARRËSË
Java 3	Ligjerata	NATYRA E BIZNESIT TË VOGËL
Java 4	Ligjerata	KREATIVITETI DHE INOVACIONI
Java 5	Ligjerata	RREZIKU DHE NDËRMARRËSIA
Java 6	Ligjerata	PLANI I BIZNESIT DHE NDËRMARRËSIA
Java 7	Ligjerata	OPCIONE PËR HYRJE NË NDËRMARRËSI
Java 8	Ligjerata	Kollkofium 1
Java 9	Ligjerata	FRANSHIZA SI OPCION NDËRMARRËS
Java 10	Ligjerata	FINANCIMI I BIZNESIT NDËRMARRËS
Java 11	Ligjerata	MARKETINGU NDËRMARRËS
Java 12	Ligjerata	NDËRMARRËSIA DIGJITALE
Java 13	Ligjerata	NDËRMARRËSIA KORPORATIVE
Java 14	Prezentime	Prezentimi i biznes planeve
Java 15	Test	Kollokfiumi 2

Tekstet kryesore

Titulli: Ndërmarrësia dhe menaxhimi i biznesit të vogël

Autorë: Veland Ramadani, Robert D. Hisrich, Nora Sadiku-Dushi & Shqipe Gërguri-Rashiti

Botuesi: UEJL, Tetove

Viti: 2022

Materiali plotësues

John Bessant, "Entrepreneurship and innovation", 2019, Publisher: John Wiley & Sons Inc.

Peter F. Drucker, "Innovation and Entrepreneurship", 2006

Charles Hampden-Turner, "Teaching Innovation and Entrepreneurship", 2009, Cambridge University Press

Lubar and Halpern, "Leadership Presence", 2004

Projektet

Plani i biznesit

Në këtë lëndë do të jepet projekt grupor, i cili ka të bëjë me hartimin e një *plani të biznesit*. Grupi mund të përbëhet nga 3 studentë. Projekti grupor dhe prezantimi do të vlerësohet me 20% të suksesit (punimi dhe prezantimi- piket do të vlejne për secilin anëtar të grupit me kusht që të deshmoj kontributin në punim 15% dhe të jetë prezent në prezantim 5%), nëse dorëzohet dhe prezantohet në afatin e caktuar. Studentët mund të zgjedhin grupin më të cilin duan të punojnë. Nëse ata nuk arrijnë të zgjedhin grupin, bartësi i lëndës do t'i formojë grupet. Studentët në çdo orë të seminareve do të raportojnë rreth detyrave të parashtruara nga bartësi i lëndës. Nëse projekti grupor nuk prezantohet në afatin e caktuar, studentët nuk do të mund t'i fitojnë pikët e mundshme. Plani i biznesit duhet të përmbajë rreth 20 faqe. Data e dorëzimit: [deri më _____ në Google Classroom](#).

Inervista me ndërmarrës

Studentët duhet të realizojnë **intervistë me ndonjë ndërmarrës vendor**. Intervista realizohet individualisht.

Përmbajtja e *Raportit të intervistës* duhet të ofrojë informacion për këto çështje:

1. Emri dhe përshkrimi i ndërmarrjes.

2. Historiku i ndërmarrësit para fillimit të ndërmarrjes.
3. Karakteristikat e ndërmarrësit.
4. Origjina e ndërmarrjes (pse filloi, motivet?).
5. Industria dhe përshkrimi i tregut.
6. Ngjarjet kryesore historike në fillimin dhe ekzistencën e ndërmarrjes.
7. Gjendja aktuale e ndërmarrjes.
8. Sfida të mëdha aktuale dhe të ardhshme dhe mundësi të reja për ndërmarrjen.
9. Si gjetjet nga intervista ndikojnë në qëndrimet, sjelljet dhe frymëzimet e studentëve ndaj themelimit dhe posedimit të ndërmarrjes personale
10. Përfundoni me një prezantim që pasqyron atë që keni mësuar nga përvoja e intervistimit të ndërmarrësit dhe gjatë hulumtimit dhe shkrimit të raportit të intervistës.

Raporti i intervistës dhe prezantimi do të vlerësohet me 10% të suksesit, nëse dorëzohet dhe prezantohet në afatin e caktuar. Data e dorëzimit: *deri më _____ në Google Classroom.*

Pjesëmarrja aktive në ligjerata	10
Projekti- Plani i biznesit dhe prezentimi	20
Detyra – intervista me ndërmarrës dhe prezentimi	10
Provimi i gjysmë-semestrit/Kolokfiumi I	30
Provimi i gjysmë-semestrit/Kolokfiumi II	30
<i>Provimi përfundimtar</i>	60
Totali	100

Vërejtje: Nëse detyrat e kërkuara nuk dorëzohen dhe prezentohen me kohë, pikët maksimale që student mund të marrë në provimin final janë 60.